



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:101177
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05748310

C.nr.326/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve E.D, L.O, V.D, H.D, dhe M.E, të gjithë nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit i përfaqëson avokati A.M, nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe pagave në emër të pensionimit, vlera e objektit të kontestit 1,976.23 euro, jashtë seancës, më datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve E.D, L.O, V.D, H.D, dhe M.E, të gjithë nga Rahoveci, me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që të paditësit të parë E.D, për 40 vjet, 6 muaj e 27 ditë, përvojë në punë, në vlerë prej 150 % nga paga bazë, përkatësisht shumën prej 909.79 €, paditëses së dytë L.O, për 10 vjet, 6 muaj e 20 ditë, përvojë në punë, në vlerë prej 50 % nga paga bazë, përkatësisht shumën prej 239.00 €, paditësit të tretë V.D, për 22 vjet, 3 muaj e 12 ditë, përvojë në punë, në vlerë prej 75 % nga paga bazë, përkatësisht shumën prej 239.00 €, paditëses së katërt H.D, për 21 vjet, 8 muaj e 17 ditë, përvojë në punë, në vlerë prej 75 % nga paga bazë, përkatësisht shumën prej 359.00 €, paditëses së pestë M.E, për 11 vjet, 3 muaj e 24 ditë, përvojë në punë, në vlerë prej 50 % nga paga bazë, përkatësisht shumën prej 229.44 €, në shumë të përgjithshme prej 1,976.23 euro, me kamatë ligjore, nga dita e ushtrimit të padisë e deri te pagesa definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

DETYROHEN paditësit E.D, L.O, V.D, H.D, dhe M.E, që të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 312,00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësit E.D, L.O, V.D, H.D, dhe M.E, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 02.05.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompenzimin pagave jubilarë, në shumën prej 1,976.23 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në përgjigjen e saj në padi të datës 14.08.2022, ka theksuar se e kontestojmë kërkesëpadinë e paditësve ndaj të paditurës, duke vlerësuar e paditura e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, ngase konsideron se padia si e tillë është e pa themeltë dhe e pabazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit. Gjithashtu, padia e paditësve është e pas afatshme, nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse, rezulton se është parashkruar në tërësi. Paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë më 02.05.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensim pagave jubilarë përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, kjo Kontratë ka qenë në fuqi deri më datë 21.01.2021. E paditura konsideron se vlefshmëria dhe zbatueshmëria e KKAK-së të vitit 2017, që ka qenë në fuqi nga data 18.04.2017 e deri më 21.01.2021, është përcaktuar sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të datës 27.02.2023, Kapitulli 11 pika IV. Sipas listës së pagave nga Thesari i Shtetit, vërtetohet fakti i pakontestueshëm se paditësi E.D, në kohën e parashtrimit të padisë me datë 02.05.2023, i ka arritur 40 vitet e përvojës së punës, në kohën kur nuk ka pasur kontratë kolektive të arsimit në fuqi. Paditësja L.O, në kohën e parashtrimit të padisë me datë 02.05.2023, i ka arritur 36 vitet e përvojës së punës. Paditësi V.D, në kohën e parashtrimit të padisë me datë 02.05.2023, i ka arritur 36 vitet e përvojës së punës. Paditësja H.D, në kohën e parashtrimit të padisë me datë 02.05.2023, i ka arritur 37 vitet e përvojës së punës. Paditësja M.E, në kohën e parashtrimit të padisë me datë 02.05.2023, i ka arritur 16 vitet e përvojës së punës. Në bazë të kësaj gjendjeje faktike, e paditura konsideron se paditësve nuk i takon kompensimi në emër të shpërbllimit jubilar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 163/23 i datës 29.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për paditësin E.D; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 475/2 i datës 2512/3, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec, për paditësin E.D; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 129/21 i datës 11.10.2019, i lëshuar nga SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec, për paditësin E.D; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1006 i datës 11.10.2021, i lëshuar nga SHFL “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec, për paditësin E.D; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 162/23 i datës 29.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për paditësen L.O; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 152/23 i datës 28.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për paditësin V.D; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 161/23 i datës 30.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për paditësen H.D; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 407/15 i datës 04.05.2015, i lëshuar nga SHFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxe, për paditësen H.S; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë i datës 04.05.2015, i lëshuar nga SHFMU “Mihal Grameni” në Rahovec, për paditësen H.S; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 147/23 i datës 24.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa

Boletini” në Rahovec, për paditësen M.E; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 756/01 i datës 22.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec, për paditësen M.E; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 150/23 i datës 24.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për paditësen M.E; si dhe lista e pagës të datës 01 Tetor 2019, 31 Dhjetor 2019, 28 Tetor 2023,

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e pagës jubilarë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 163/23 i datës 29.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se E.D ka përvojë pune 41 vite e 6 muaj e 27 ditë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 475/2 i datës 2512/3, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se E.D ishte në marrëdhënie pune si mësimdhënës i Edukatës Fizike, në këtë shkollë prej 01.09.2015 – 11.02.2020.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 129/21 i datës 11.10.2019, i lëshuar nga SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se E.D ishte në marrëdhënie pune si mësimdhënës i Edukatës Fizike, në këtë shkollë prej 01.09.2004 – 31.08.2015.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1006 i datës 11.10.2021, i lëshuar nga SHFL “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se E.D ishte në marrëdhënie pune si mësimdhënës i Edukatës Fizike, në këtë shkollë prej 01.09.1980 – 31.08.2004.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 162/23 i datës 29.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se L.O ka përvojë pune 40 vite e 6 muaj e 28 ditë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 152/23 i datës 28.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se V.D ka përvojë pune 42 vite e 3 muaj e 12 ditë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 161/23 i datës 30.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se H.D ka përvojë pune 41 vite e 8 muaj e 17 ditë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 407/15 i datës 04.05.2015, i lëshuar nga SHFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxe, gjykata vërtetoi faktin se H.S ishte në marrëdhënie pune si mësimdhënës, në këtë shkollë prej 10.03.1981 – 30.06.1981.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë i datës 04.05.2015, i lëshuar nga SHFMU “Mihal Grameni” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se H.S ishte në marrëdhënie pune si mësimdhënës, në këtë shkollë prej 24.10.1981 – 31.08.1982.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 147/23 i datës 24.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se M.E ka përvojë pune 21 vite e 3 muaj e 24 ditë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 756/01 i datës 22.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se M.E ishte në marrëdhënie pune si mësimdhënës, në këtë shkollë prej 01.09.2004 – 01.04.2018.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 150/23 i datës 24.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se M.E ka lidh marrëdhënie pune prej 01.10.2001 deri me 31.08.2003.

Me administrimin e listës së pagës të datës 28 Tetor 2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.D ka 40 vite përvojë të punës.

Me administrimin e listës së pagës të datës 31 Dhjetor 2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësja L.O ka 36 vite përvojë të punës.

Me administrimin e listës së pagës të datës 01 Tetor 2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.D ka 36 vite përvojë të punës.

Me administrimin e listës së pagës të datës 31 Dhjetor 2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.D ka 37 vite përvojë të punës.

Me administrimin e listës së pagës të datës 31 Dhjetor 2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M.E ka 16 vite përvojë të punës.

Gjykata ka vendosur ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësi i parë E.D, ka kërkuar në emër të shpërblimit jubilar për 40 vjet, 6 muaj e 27 ditë, t’ia paguaj 150 % të pagës bazë, përkatësisht shumën prej 909.79 €, me vetë faktin se i njëjti më datën 28 Shkurt 2023 kishte 40 vite përvojë pune, i njëjti vitin jubilar e katërdhjetë e ka arritur në vitin 2023, kur nuk kishte Kontratë Kolektive, ngase Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 22.01.2021, e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri me datën 21.11.2022. Paditësja e dytë L.O, ka kërkuar në emër të shpërblimit jubilar për 10 vjet, 6 muaj e 20 ditë, t’ia paguaj 50 % të pagës bazë, përkatësisht shumën prej 239.00 €, me vetë faktin se e njëjta më datën 31 Dhjetor 2019 kishte 36 vite përvojë pune, e njëjta vitin jubilar e dhjetë e ka arritur në vitin 1993, kur nuk kishte Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive, ndërsa edhe po të kishte, e njëjta do të ishte e parashkruar. Paditësi i tretë V.D, ka kërkuar në emër të shpërblimit jubilar për 22 vjet, 3 muaj e 12 ditë, t’ia paguaj 75 % të pagës bazë, përkatësisht shumën prej 239.00 €, me vetë faktin se i njëjti më datën 01 Tetor 2019 kishte 36 vite përvojë pune, i njëjti vitin jubilar e njëzet e ka arritur në vitin 2003, kur nuk kishte Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive, ndërsa

edhe po të kishte, e njëjta do të ishte e parashkuar. Padiësja e katërt H.D, ka kërkuar në emër të shpërblimit jubilar për 21 vjet, 8 muaj e 17 ditë, t'ia paguaj 75 % të pagës bazë, përkatësisht shumë prej 359.00 €, me vetë faktin se e njëjta më datën 01 Dhjetor 2019 kishte 37 vite përvojë pune, e njëjta vitin jubilar e njëzet e ka arritur në vitin 1992, kur nuk kishte Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive, ndërsa edhe po të kishte, e njëjta do të ishte e parashkuar. Padiësja e pestë M.E, ka kërkuar në emër të shpërblimit jubilar për 11 vjet, 3 muaj e 24 ditë, t'ia paguaj 50 % të pagës bazë, përkatësisht shumë prej 229.44 €, me vetë faktin se e njëjta më datën 31 Dhjetor 2019 kishte 16 vite përvojë pune, e njëjta vitin jubilar e dhjetë e ka arritur në vitin 2012, kur nuk kishte Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive, ndërsa edhe po të kishte, e njëjta do të ishte e parashkuar.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë kërkesëpadinë e padiësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar padiësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 82 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, nenit 399 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit dhe 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.326/2023, më datën 29.05.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.